



Ky projekt financohet
nga Bashkimi Evropian



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Raporti i monitorimit të Pjesëmarrjes Politike, Sociale dhe Ekonomike të të Rinjve

Shqipëria 2020



Hulumtues

Era Sherifaj

Kontribues

Jonida Alite

Grafika dhe Faqosja

Kristina Lato

Ky raport monitorimi u përgatit si pjesë e projektit Punësimi i të Rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqi, financuar nga Bashkimi Evropian. Projekti zbatohet nga Ana and Vlade Divac Foundation (Serbi), Organizata Prima (Mali i Zi), Aleanca Rinore (Maqedonia e Veriut), Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (Shqipëri) dhe Fondacioni i Komunitetit të Vullnetarëve (Turqi).

Ky publikim u përgatit me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e tij është përgjegjësi vetëm e Partnerëve Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Në brendësi të këtij raporti



Përmbledhje

Faqe 3



Të dhëna mbi pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve

Faqe 5



Krahasim të të dhënave gjatë 4 viteve të monitorimit

Faqe 11



Rekomandimet për politika dhe çështjet e advokimit

Faqe 12



Ndikimi i COVID- 19 në pjesëmarrjen e të rinjve

Faqe 15


Partnerët Shqipëri në kuadër të projektit “Punësimi i të rinjve në Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë” zbatuar në partneritet me Fondacionin “Ana dhe Vlade Divac” në Serbi, Aleancën Rinore në Maqedoninë e Veriut, organizatën “Prima” në Mal të Zi dhe “Fondacionin e Komunitetit të Vullnetarëve” në Turqi publikojnë një raport vjetor monitorimi që synon të vërë në dukje dhe të analizojë situatën në lidhje me pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve në këto 5 vende.

Raporti i monitorimit u publikua për herë të parë në vitin 2016 si pjesë e iniciativës së Youth Bank Hub për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë. Ky raport ofron një përshkrim të shkurtër të të dhënave aktuale mbi pjesëmarrjen politike, sociale dhe ekonomike të të rinjve në Shqipëri bazuar në një grup indikatorësh të paracaktuar. Duke marrë parasysh që ky është raporti i pestë vjetor, ai ofron një krahasim të rëndësishëm të të dhënave gjatë periudhës 2016 - 2020.

Të dhënat e raportit janë rezultat i hulumtimeve dhe kërkesave zyrtare për informacion dërguar institucioneve përgjegjëse siç janë: Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Instituti Kombëtar i Statistikave dhe Bashkive.

Raporti shërben si udhëzues për iniciativa advokuese bazuar në evidenca për iniciativat e ardhshme në lidhje me gjendjen e të rinjve në kuadër të pjesëmarrjes politike, sociale dhe ekonomike.

Të dhënat e këtij raporti janë pasqyruar gjithashtu në Raportin Vjetor rajonal të rrjetit Hub-i Rinor për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë, i cili reflekton të dhëna krahasuese nga të 5 raportet e vendeve të targetuara.



“Fakti që disa të dhëna
mbi përfshirjen sociale
të të rinjve nuk maten
dhe as nuk
përditësohen mbetet
një çështje për t'u
adresuar”


Të Dhëna Mbi Pjesëmarrjen Politike Të Të Rinjve

INDIKATORËT	TOTALI	FEMËR	MASHKULL	VITI
Ministrat e rinj në qeveri	0%	0%	0%	2020 ¹
Zëvendësministrat e rinj në qeveri	3%	3%	0%	2020 ¹
Deputetët e rinj në parlament	4%	3%	1%	2020 ¹
Kryebashkiakë të rinj	0%	0%	0%	2020 ¹
Mjete on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e qeverisë dhe parlamentit	98%			2020 ¹
Mjetet on-line për informim dhe pjesëmarrje në vendimmarrjen e bashkive	74%			2020 ¹
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel kombëtar	0%			2020 ²
Ekzistenca e strukturave rinore (këshillat / parlamentet / bordet) në nivel lokal	46%			2020 ³

[1] Hulumtim

[2] Kërkesë për informacion Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë

[3] Kërkesë për informacion në 61 Bashkitë e Shqipërisë

A large crowd of people is gathered in a city street, with buildings in the background. The scene is captured from an elevated perspective, showing a dense crowd of people filling the street and sidewalks. The buildings are multi-story, with some having balconies and windows. The overall atmosphere suggests a significant public event or protest. The image is overlaid with a dark blue semi-transparent rectangle containing white text.

“2020 shënon
përqindjen më të
lartë të përdorimit
të mjeteve online
ndër vite”

Të Dhëna Mbi Pjesëmarrjen Sociale Të Të Rinjve

INDIKATORËT	TOTALI	FEMËR	MASHKULL	VITI
Të rinjtë në rrezik varfërie	Nuk ka të dhëna	-	-	2020 ⁴
Përqindja e të rinjve të varfër (të rinjtë që jetojnë nën vijën e varfërisë) (Jo i të rinjve të varfër / jo i të rinjve)	Nuk ka të dhëna	-	-	2020 ¹
Të rinjtë në burgje	30%	0%	30%	2020 ⁵
Të rinjtë pjesë e sistemit të mbrojtjes sociale (të cilët marrin mbështetje financiare nën sistemin e mbrojtjes sociale) pjesëtuar me të rinjtë që janë në sistemin e mbrojtjes sociale	Nuk ka të dhëna	-	-	2020 ⁶
Braktisja e shkollës së mesme	1.8%	0.9%	2.8%	2019-2020 ²
Të rinjtë e regjistruar në arsimin e lartë	91.6%	-	-	2019-2020 ¹
Të rinjtë e diplomuar në arsimin e lartë	25%	28%	22%	2019-2020 ¹

[1] Hulumtim

[2] Kërkesë për informacion Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë

[3] Kërkesë për informacion në 61. Bashkitë e Shqipërisë

[4] Partnerët Shqipëri i dërguan një kërkesë për informacion Institutit Kombëtar të Statistikave, por ata u përgjigjën se këto të dhëna nuk maten për vitin 2020

[5] Kërkesë për informacion pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve

[6] Partnerët Shqipëri i dërguan një kërkesë për informacion Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por Ministria nuk u përgjigj

[7] Kërkesë për informacion pranë Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT)

“Numri i nxënësve
që braktisin arsimin
e mesëm është
përgjysmuar
krahasuar me pesë
vite më parë”


Të Dhëna Për Pjesëmarrjen Ekonomike Të Të Rinjve

INDIKATORËT	TOTALI	FEMËR	MASHKULL	VITI
Norma e NEET	27.9%	30%	25.8%	2020 ⁸
Shkalla e papunësisë së të rinjve	20.9%	21.1%	20.8%	2020 ⁷
Shkalla e papunësisë afatgjatë së të rinjve	11.4%	10.2%	12.6%	2020 ⁷
Shkalla e pjesëmarrjes së forcës punëtore të të rinjve	52.1%	44.7%	59.3%	2020 ⁷
Shkalla e punësimit të të rinjve	41.2%	35.3%	46.9%	2020 ⁷
Të rinjtë që themeluan biznesin e tyre me mbështetjen financiare të shtetit	3%	-	-	2020 ⁹
Të rinjtë e vetëpunësuar	18.5%	16.5%	20.5%	2020 ¹

[7] Kërkesë për informacion pranë Institutit Kombëtar të Statistikave (INSTAT)

[8] Instat- Shqipëria në shifra 2020

[9] Kërkesë për Informacion Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural



“Në pesë vitet e fundit numri i të rinjve që kanë filluar biznesin e tyre me mbështetjen e shtetit është ulur me 51.5%”.

Krahasimet e të dhënave gjatë 5 viteve të monitorimit

Në përgjithësi, disa indikatorë kanë ndryshuar si pozitivisht dhe negativisht ndër vite, por krahasuar me të dhënat e raportuara në indeksin e parë, të pesë viteve më parë, vërehet një përmirësim i dukshëm.

Disa nga indikatorët në **Dimensionin e Pjesëmarrjes Politike** kanë mbetur të njëjtë. *Numri i ministrave të rinj në qeveri* dhe *ekzistenca e strukturave rinore në nivel kombëtar* nuk kanë shënuar progres ndër vite dhe kanë mbetur të pandryshuara në 0%.

Ndërsa *numri i zëvendësministrave të rinj* në qeveri dhe *strukturave rinore në nivel lokal* ka arritur nivelin më të lartë në vitin 2019 përkatësisht me 7% dhe 57.4%, në vitin 2020 të dy indikatorët kanë shënuar rënie, veçanërisht strukturat rinore me 11.4% krahasuar me vitin e mëparshëm.

Numri i *kryebashkiakëve të rinj* në Shqipëri ka qenë konstant deri në vitin 2018, por këto dy vitet e fundit ka ndodhur një ndryshim i rëndësishëm dhe e ka ulur normën nga 6% në 0%.

Viti 2020 shënon përqindjen më të lartë të përdorimit të mjeteve online ndër vite. *Mjetet online për informim dhe pjesëmarrje në vendimarrje* në nivel qeverie dhe parlamenti, janë rritur me 18,7%, në vitin 2020. Gjithashtu *mjetet online për informim dhe pjesëmarrje në vendimarrjen në nivel vendor* kanë treguar një rritje pozitive ndër vite me përqindjen më të lartë në 2020 me 74%.

Në **Dimensionin e Pjesëmarrjes Sociale**, mungon informacioni mbi indikatorë të tillë si *të rinjtë në rrezik varfërie*, përqindja e *të varfërve* dhe *të rinjve pjesë e sistemit të mirëqenies sociale*, sepse këto indikatorë mbeten të pa matura nga institucionet përgjegjëse ose institucionet kanë dështuar në dhënien e informacioneve.

Të dhënat *për të rinjtë në burgje* tregojnë një rënie domethënëse në dy vitet e fundit me një mesatare prej 9%, ndërkohë që viti 2020 shfaq përqindjen më të ulët të të rinjve në burgje që nga viti 2016.

Indikatorët e arsimit tregojnë përmirësime të ndjeshme krahasuar me indeksin e vitit të parë të monitorimit, veçanërisht braktisja e arsimit të mesëm, i cili është i vetmi indikator që ka shënuar rënie gjatë gjithë viteve, me vlerën më të ulët në vitin 2020 me 1.8%.

Norma e të *rinjve të regjistruar në arsimin e lartë* ka pasur një ndryshim të lehtë dhe të vazhdueshëm në kufijtë 90% deri në vitin 2018, por në vitin 2019 është vërejtur një rënie me 25.5%, i cili është përmirësuar ndjeshëm në vitin 2020 me një rritje prej 91.6%.

Ndërsa *të rinjtë e diplomuar në arsimin e lartë* kanë shënuar një tendencë rritjeje në vlera të vogla me një mesatare prej 2% gjatë 4 viteve (2016-2019), ndërsa në vitin 2020 për herë të parë ky indikator ka pësuar rënie të normës së të rinjve të diplomuar në arsimin e lartë me 1.7% krahasuar me vitin 2019. Krahasuar me burrat e rinj, gratë e reja janë më të përkushtuara ndaj arsimit dhe kanë një përqindje më të ulët të braktisjes së arsimit të mesëm dhe një shkallë më të lartë të diplomimit në arsimin e lartë.

Përsa i përket dimensionit të **pjesëmarrjes ekonomike**, ndryshime të indikatorëve kanë shoqëruar vitin 2020, si norma *NEET*, e cila ka patur një tendencë rënie me përqindje të vogla ndër vite, me rënie më të lartë në vitin 2019, por në vitin 2020 përqindja është rritur lehtë me 1.3%. *Papunësia e të rinjve* dhe *shkalla e papunësisë afatgjatë* janë indikatorët e pjesëmarrjes ekonomike të cilët kanë shënuar rënie në të gjitha vitet. Ndërsa *shkalla e punësimit të të rinjve* dhe *shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore të të rinjve* janë rritur ndër vite përkatësisht me 8.8% dhe 6.4% në krahasim me 5 vite më parë. Indikatorin i cili ka shënuar një rënie të ndjeshme prej 51.5% janë të rinjtë që kanë filluar biznesin e tyre me mbështetjen e shtetit, duket qartë se mbështetja shtetërore pothuaj është zhdukur me kalimin e viteve. Të dhënat për *të rinjtë e vetëpunësuar* janë rritur me një mesatare prej 9,13% këto dy vitet e fundit pas një rënie të konsiderueshme prej 17,4% në 2018.

Burrat e rinj vazhdojnë të kenë një përfshirje më të lartë se gratë e reja në shkallën e punësimit të të rinjve, pjesëmarrjen e të rinjve në fuqinë punëtore, normën *NEET*, shkallën e papunësisë së të rinjve dhe vetëpunësimin. Ndërsa gratë e reja kanë një performancë më të mirë krahasuar me burrat në indikatorin e normës afatgjatë të papunësisë.

Rekomandime të politikave dhe çështjeve për advokim

Ky sesion ofron disa rekomandime politikash për secilin dimension, të cilat duhet të adresohen nga institucionet dhe aktorët që punojnë në fushat përkatëse.

Në të pestin vit radhazi të monitorimit, mbetet ende problem mungesa e të dhënave statistikore për pjesëmarrjen sociale të të rinjve.

PJESËMARRJA POLITIKE E TË RINJVE

- Situata pandemike dhe mungesa e përvojës së bashkive në krijimin dhe aktivitetet e *strukturave rinore*, ka sjellë uljen e numrit dhe veprimtarisë së strukturave rinore gjatë vitit 2020. Shumica e bashkive bashkëpunojnë me organizatat e shoqërisë civile për krijimin e këtyre strukturave, por është e nevojshme të krijohet një manual udhëzues (*praktikat më të mira të bashkive si shembull*) i cili do të lehtësonte dhe unifikonte mënyrën e organizimit dhe funksionimit të këtyre strukturave në të gjitha bashkitë.
- Në vitin 2020 nuk ka pasur zgjedhje dhe *përfaqësimi në parlament i deputetëve të rinj* vazhdon të mbetet i njëjtë me vitin e kaluar me 4%, ndërsa numri i *kryetarëve të rinj të bashkive* vazhdon të mbetet 0% në 2020, e njëjte me vitin 2019, për shkak të mospjesëmarrjes së partive opozitare në zgjedhjet lokale të 2019.
- Ka një rritje të konsiderueshme për sa i përket *mjeteve online të përdorura për informacion dhe pjesëmarrje në vendimmarrje* si në nivel qendror ashtu edhe në atë vendor. Megjithatë, është e vështirë të aksesosh disa nga faqet e mediave zyrtare të institucioneve publike, ndërsa disa të tjera nuk e përmbajnë informacionin që duhet të ofrojnë ose informacioni është shumë i vjetër. Në këtë kontekst, ministrinë dhe bashkitë duhet të përditësojnë faqet e tyre të informimit dhe mediave sociale, si dhe të ndajnë më shumë informacion me qytetarët e tyre dhe t'u ofrojnë atyre mundësinë për të marrë pjesë në aktivitete dhe procese të ndryshme.

PJESËMARRJA SOCIALE E TË RINJVE

- Duke marrë parasysh faktin se gjatë vitit 2020 të gjitha mësimet janë zhvilluar online, ka patur probleme të shumta në strategjinë dhe infrastrukturën e përdorur. Ndërsa pandemia vazhdon, është e rëndësishme të krijohen kurrikula që kuptohen nga studentët dhe transmetohen lehtësisht përmes mediave online. Teknologjia luajti një rol kyç gjatë kësaj periudhe, prandaj edukimi i studentëve në fushën e teknologjisë dhe pajisja e shkollave me lehtësirat e nevojshme duhet të jetë parësore.
- Shkollat duhet të bashkëpunojnë më shumë me organizatat e shoqërisë civile për të zhvilluar trajnime në tema të ndryshme, si të drejtat e të rinjve, përfshirja në vendimmarrje, shkrimi i projekteve, të cilat rrisin aftësitë e nxënësve përtej kurrikulës.
- Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë duhet të aplikojë programe mbështetëse për të rinjtë e grupeve të marginalizuara, për t'i ndihmuar ata të vazhdojnë studimet.
- Një fokus i veçantë duhet t'i kushtohet krijimit të qendrave të këshillimit të karrierës në shkollat e mesme, të pajisura me staf të kualifikuar dhe profesional, me qëllim orientimin e të rinjve në përzgjedhjen e rrugëtimit të tyre profesional.
- Institucionet përkatëse, bashkitë dhe Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë duhet të krijojnë më shumë hapësira publike kushtuar aktiviteteve kulturore dhe sportive, në të gjitha qytetet.
- Është thelbësore që institucionet përgjegjëse të identifikojnë *të rinjtë në rrezik varfërie* dhe *të rinjtë e varfër* dhe t'i ndihmojnë ata për të përmirësuar gjendjen e tyre dhe për të parandaluar emigrimin e tyre.
- Përmirësimi i kurrikulave arsimore, marrëdhënieve nxënës-mësues, aktivitetet ekstrakurrikulare, prania e këshilluesve të karrierës dhe psikologëve janë ndër elementët që angazhojnë të rinjtë dhe i mbajnë larg krimit dhe veprimtarive të paligjshme.
- Për *të rinjtë në burgje* është e nevojshme ngritja e programeve riintegruese të përshtatura për nevojat e tyre. Trajnimet me tema të ndryshme, kurse të teknologjisë së informacionit dhe trajnime profesionale në interes të tyre do të ishin shumë të vlefshme për zhvillimin e kapaciteteve të të rinjve të nevojshme për tregun e punës. Një informacion i vazhdueshëm se çfarë po ndodh dhe cilat janë zhvillimet kryesore në nivel lokal, kombëtar dhe global mbetet i rëndësishëm.

PJESËMARRJA EKONOMIKE E TË RINJVE

- Norma **NEET** në vitin 2020 ka shënuar një rritje me 1.3% në krahasim me vitin 2019. Në uljen e nivelit të lartë të normës NEET, luajnë një rol të rëndësishëm institucionet përkatëse duke qenë vazhdimisht vigjilente dhe duke identifikuar grupet e të rinjve pjesë e NEET, duke analizuar problemet e tyre dhe duke ndërmarrë veprime për angazhimin e të rinjve në arsim, trajnime dhe më vonë në punësim përmes programeve të ndryshme mbështetëse.
- Një çështje tjetër e advokimit është fuqizimi i mekanizmave për kërkimin e punës dhe aksesin nëpërmjet përmirësimit të mjeteve online për informim. Krijimi i një platforme që përfshin të gjitha vendet vakante nga institucionet publike dhe private në Shqipëri do të kontribuonte pozitivisht në uljen e shkallës së papunësisë tek të rinjtë.
- Për të përshtatur kërkesën dhe ofertën në tregun e punës dhe për të harmonizuar prirjet e nxënësve me nevojat e tregut, është i nevojshëm krijimi i qendrave të këshillimit të karrierës të cilat ofrojnë konsulencë por edhe bëjnë kërkime që specifikojnë nevojat e tregut dhe orientojnë nxënësit drejt vendeve të punës që i takojnë së ardhmes.
- Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve nuk ka dhënë grante financiare nga buxheti i shtetit, për periudhën janar – dhjetor 2020. Një mbështetje e vogël prej rreth 3% për të rinjtë ka ardhur nga Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural. Është e qartë se mungesa e fondeve të siguruara nga shteti vazhdon të jetë problem. Është e rëndësishme të sigurohet më shumë akses në financim për **sipërmarrësit e rinj** si nga pushteti qendror ashtu edhe nga ai vendor. Duhet jo vetëm krijimi i më shumë fondeve fillestare, por edhe promovimi i të gjitha skemave financiare të disponueshme për sipërmarrësit e rinj në Shqipëri. Gjithashtu, informacioni duhet të jetë i aksesueshëm nga të gjithë të rinjtë që jetojnë në zonat urbane dhe rurale, shoqëruar me më shumë transparencë për përdorimin e fondeve.
- Megjithatë, fatmirësisht në Shqipëri veprojnë shumë organizata vendase dhe të huaja, të cilat mbështesin sipërmarrësit e rinj me mbështetje financiare dhe mentorim duke u mundësuar atyre të zhvillohen më tej. Qeveria po punon për krijimin e Tekno Parkut të parë në Shqipëri, i cili do t'ju mundësojë të gjithë bizneseve të vogla dhe të mesme të punojnë në një hapësirë të përbashkët, por kjo nuk eliminon nevojën për një inkubator dhe akselerator profesional në nivel kombëtar, i cili do të ofrojë paketa që përfshijnë akses në fonde, programe trajnime dhe mentorimi, mundësi rrjetëzimi, ekspozim ndaj tregjeve ndërkombëtare, engjëjve të biznesit dhe skemave të investimit.

Ndikimi i COVID-19 në pjesëmarrjen e të rinjve

COVID-19 ka ndikuar në të gjitha aspektet e jetës së të rinjve në Shqipëri dhe botë, duke ndikuar edhe pjesëmarrjen e tyre sociale, ekonomike dhe politike.

Që nga mbyllja e shkollave në mars 2020, rreth 572,000 nxënës nga arsimit parashkollor në arsimin e lartë kaluan në mësimin online, gjë që kufizoi ndërveprimin social të të rinjve brenda ambienteve të shkollës. Aksesit në mësimin online ishte gjithashtu një problem i madh pasi rreth 11,000 studentë, kryesisht ata që jetojnë në zonat rurale, nuk kanë akses në mësimin online për shkak të mungesës së aksesit në internet ose pajisjeve dixhitale në shtëpi. Gjithashtu, kur merren parasysh fëmijët me vështirësi dhe paaftësi në të nxënë, 1 në 2 fëmijë me aftësi të kufizuara nuk mund të aksesojë aktivitetet edukative online.¹⁰ Vështirësitë në procesin e zhvillimit të mësimin online kanë ndikuar edhe në një rënie me 1,7% të numrit të të diplomuarve krahasuar me vitin 2019.

Për shkak të periudhës së karantinës dhe masave kufizuese për grumbullimin dhe lëvizjen e njerëzve, sipas informacioneve të vëna në dispozicion nga bashkitë, numri i qendrave rinore dhe bashkë me to aktivizimi dhe aktivitetet rinore janë ulur me 11.4% krahasuar me vitin 2019. Bashkitë kanë punuar për të bërë të mundur përfshirjen e të rinjve në vendimmarrje përmes platformave online, duke l ftuar të rinjtë të marrin pjesë në diskutime për tema të ndryshme në komunitetin e tyre.

Situata pandemike ka prekur bizneset në çdo sektor të ekonomisë, veçanërisht ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NMV-të). Për shkak të masave kufizuese të COVID-19, ato u përballën me reduktim të shfrytëzimit të kapaciteteve, ofertës së fuqisë punëtore dhe mungesës së likuiditetit. Si pasojë, NMV-të nuk ishin në gjendje të paguanin pagat për punonjësit e tyre. Nga sondazhet e deritanishme rezultoi se përveç mungesës së klientëve, mungesës së likuiditetit dhe mungesës së planit të emergjencës, bizneset e vogla kanë vështirësi në përmbushjen e detyrimeve tatimore.

Gjithashtu, numri i të rinjve të vetëpunësuar është ulur me 10.7%, kryesisht për shkak të situatës së vështirë dhe mungesës së mbështetjes nga qeveria. Shkalla e varfërisë në Shqipëri vlerësohet të dyfishohet në një kohë të shkurtër me supozimin se të vetëpunësuarit humbasin 100% të të ardhurave të tyre dhe punonjësit humbasin 50% nga paga e tyre, duke rezultuar në një shtesë prej 115,000-230,000 njerëz që lëvizin nën kufirin e varfërisë në vend.¹⁰

Papunësia ka shënuar rënie të lehtë me 0.6%, ndërkohë që shkalla e punësimit të të rinjve dhe shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore nuk kanë ndryshuar në krahasim me vitin 2019. Edhe pse COVID-19 mund të mos ketë patur ndikim të menjëhershëm tek këta indikatorë, procesi është shoqëruar me stresin e vazhdueshëm se vendet e punës janë në rrezik për shkak të masave dhe situatës pandemike.

Si përfundim, edhe pse viti 2020 ka qenë një vit i vështirë për shkak të COVID-19 dhe faktorëve të tjerë që mund të kenë ndikuar në uljen e pjesëmarrjes së të rinjve, qeveria duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme dhe të prezantojë metoda të reja për t'u përshtatur me situatën aktuale me synimin për t'u kthyer në normalitet sidomos për të rinjtë, të cilët janë forca lëvizëse e së ardhmes.

[10] <https://partnersalbania.org/publication/effectiveness-in-covid-19-response-albania-case-study-report/>



www.partnersalbania.org

Rruga e Elbasanit, ndërtesa Park Gate,
kati 10, ap. 71/73, Tiranë, Shqipëri

Partnerët Shqipëri
për Ndryshim dhe Zhvillim

Projekti WB&T for EmploYouth po zbatohet nga:

